



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2022:019156  
Datë: 31.01.2024  
Numri i dokumentit: 05267868

PPP.nr.12/2022

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Leart Rexhaj, me bashkëpunëtoren profesionale Shqipe Sejdiu, në çështjen përmbartimore të kreditorit SH.A. KUR “M.” J.S.C., me numër fiskal ....., kundër debitorit Xh.I nga M, për shkak të pagesës së borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm – Kartelës së konsumatorit ....., për pagesën e borxhit në shumën prej 444.35 euro, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin për lejimin e propozimit përmbartimor të përmbartuesit privat I.Sh, me seli në P. P.nr.365/21 të datës 21.07.2021, jashtë seancës gjyqësore, me datën 29.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit Xh.I nga M, SHFUQIZOHET pjesërisht urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.365/21 të datës 21.07.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat I.Sh me seli në P dhe atë për shumën e borxhit prej 424.91 euro, për periudhën nga data 01.01.2013 deri me datën 31.12.2019.

II. REFUZHOHET pjesërisht prapësimi i debitorit si i pa bazuar, ashtu që mbetet në fuqi pjesa tjetër e urdhrin të përmbartuesit privat I.Sh, me seli në P. P.nr.365/21 të datës 21.07.2021, për shumën e borxhit prej 19.44 euro, për periudhën nga data 31.01.2020 deri me datën 30.06.2021.

III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, URDHËROHET që paraprakisht të paguaj garancionin në të holla në shumën prej 19.44 euro, si parakusht për ushtrimin e ankesës, në qoftë se dështon të paguaj atë, ankesa do të konsiderohet se nuk është parashtruar fare.

### A r s y e t i m

Kreditori, SH.A. KUR “M.” J.S.C., me seli në M, më datën 21.07.2021, ka parashtruar propozim për përmbaram, ndaj debitorit Xh.I, tek përmbaruesi privat I. Sh, me seli nëP, duke kërkuar që në emër te borxhit të faturuar nga data 01.01.2013 deri me datën 14.07.2021 sipas ekstraktit të verifikuar nga librat afariste, debitori t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 444.35 euro, si dhe shpenzimet e përmbaramit dhe kamatën ligjore.

Përmbaruesi privat I.Sh, me seli në P, me urdhër përmbarues P P.nr.365/21 të datës 21.07.2021, ka lejuar përmbaramin sipas propozimit të kreditorit në këtë çështje përmbaramore.

Ndaj urdhrit të lartcekur në afatin ligjor, konkretisht me datë 18.01.2022 ka paraqitur prapësim debitori, ku ndër të tjera ka cekur se: propozimi për përmbaram është i pa bazuar dhe po ashtu kreditori asnjëherë nuk ka njoftuar debitorin për një borxh të tillë. Borxhi i pretenduar është i parashkruar konform nenit 360 par.1 pika 1.1 të LMD-së. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj propozimin për shkak të mos plotësimit të kushteve për përmbaram, për shkak të parashkrimit.

Kreditori brenda afatit ligjor, konkretisht me datë 25.01.2022 ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, me të cilën e ka kundërshtuar prapësimin si të pa pabazuar dhe të pa arsyeshëm sepse propozimi për përmbaram është paraqitur në bazë të dokumentit të besueshëm. Sa i përket pretendimeve të debitorit se i njëjti thirret në parashkrim sipas nenit 360 të LMD-së, ka theksuar se kemi ndërpreje të parashkrimit për arsye se debitori ka pranuar rregullisht shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit nga kompania, por duke dashur ti ikë përgjegjësi dhe obligimeve ka bërë pagesa për ujin e shfrytëzuar por jo në tërësi. Andaj, i ka kërkuar gjykatës që të behet ekzekutimi i propozimit për përmbaram nga debitori në llogari të kreditorit në shumën e mbetur prej 444.35 euro dhe prapësimin e debitorit ta refuzojë si të pa bazuar, sepse i njëjti nuk është arsyetuar me prova konform neni 69 par 4 të LPP -së.

Gjykata, pas shqyrtimit të propozimit të kreditorit, urdhrit për përmbaerim, prapësimit të debitorit, përgjigjes në prapësim, si dhe shkresave tjera të lëndës, ka ardhur në përfundimse:

- prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar.

Gjykata, fillimisht vlerësoi propozimin për përmbaerim të paraqitur nga kreditori dhe konstatoj se i njëjti është paraqitur konform dispozitës ligjore të nenit 38 të Ligji për Procedurën Përmbaerimore Nr.04/L-139 (në tekstin e mëtejme LPP-së) dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara me këtë dispozitë, duke ia bashkëngjitur të njëjtit dokumentin e besueshëm në origjinal, në bazë të cilit kërkohen përmbaerimi, përkatësisht ekstraktit e verifikuar nga librat afariste, i cili ekstrakt është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbaerim, në kuptim të dispozitave të nenit 29 par.1 nën par.1.2 dhe par.3 të LPP-së, ku përcaktohet se “*par.1 përmbaerimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet dhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm sipas këtij ligji është:*

*1.1. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesën e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”,* ndërsa në par.3 të këtij nenin thuhet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbaerim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjessë detyrimit monetar*”. Për çka pretendimin e debitorit se dokumenti në bazë të cilit është lëshuar urdhri përmbaerimor nuk është titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbaerueshmerisë, gjykata e mori si të pa bazuar.

Sa i përket pretendimit të debitorit, lidhur me parashkrimin e kërkesës së kreditorit, gjykata duke bërë shikimin e shkresave të lëndës, prapësimin e debitorit e ka aprovuar pjesërisht sitë bazuar në kuptim të nenit 71 par.1 nën par 1.4 të LPP-së, sipas të cilit “*ka skaduar afatikohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbaerimi*”, për shumën prej 424.91 euro, për periudhën nga data 01.01.2013 deri me datën 31.12.2019, për shkak të parashkrimittë kërkesës duke u bazuar në nenin 360 të Ligjit Mbi marrdhëniet e detyrimeve nr.04/L-077, i cili është në fuqi që nga data 20.12.2012, në të cilin theksohet se “*1.Kërkesatë cilat parashkruhen për një (1) vit, 1.1 kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake*”. Poashtu në të njëjtin nen në par.2 thuhet se “*Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë*” ndërsa në par.3 është paraparë se “*Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë*”. Andaj, për këtë pjesë të borxhit, pasi që kemi të bëjmë me shërbimet e ujësjellësit për nevoja shtëpiake, të cilat

kërkesa hynë në kategorinë e kërkesave një vjeçare, gjykata vlerësoi se ka kaluar afati i paraparë me dispozitën e lartcekura – afati i parashkrimit, pas kalimit të së cilit afat, kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore, andaj edhe vendosi si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Vendosja në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke refuzuar pjesërisht prapësimine debitorit si të pa bazuar, erdhi pasi që për këtë pjesë të borxhit nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, sepse kreditori e ka ndërprerë parashkrimin duke parashtruar propozim për përbarim me datën 21.07.2021, bazuar në nenin 369 të LMD-së, ku theksohet se *“Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose një autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesë”*. Pra, urdhri përbarimor për pjesë borxhit që përfshin periudhën nga data 31.01.2020 e deri me datën 30.06.2021, në shumë prej 19.44 euro, ka mbetur në fuqi, pasi që për këtë pjesë të kërkesës është ndërprerë parashkrimi dhe nuk ka arritur afati i paraparë me neni 360 të LMD-së.

Gjykata, vlerësoj pretendimin e kreditorit, lidhur me ndërprerjen e parashkrimit sipas nenit 368 të LMD-së, mirëpo i njëjti pretendim ishte i pabazuar, për faktin se gjykata askund në shkresat e lëndës nuk gjeti ndonjë deklaratë të debitorit me të cilën e pranon borxhin e kërkuar nga kreditori, e po ashtu nuk gjeti që i njëjti të ketë bërë ndonjë pagesë në emër të këstit, të kamatës apo dhënie të sigurimit ashtu siç e kërkon dispozita e lartcekur. Andaj gjykata konsideron se pranimi i borxhit nga ana e debitorit duhet të bëhet vetëm në mënyrë të drejtpërdrejtë me deklaratë të debitorit me gojë ose me shkrim, pranimi i borxhit duhet të jetë në atë drejtim që debitori manifeston vullnetin e tij që borxhi të pranohet në tërësi apo një pjesë e tij, përveç deklaratës të cilën debitori i'a bën kreditorit, pranimi i borxhit mund të bëhet edhe në mënyrë të tërthortë siç është pagesa e këstit, kur për borxhin paguhet një shumë e caktuar në emër të këstit, si dhe mund të bëhet edhe me pagesën e kamatës osedhënien e mjetit të sigurimit të kërkesës së kreditorit, pra lënia e sendit peng. Këto veprimetë debitorit duhet të kenë për qëllim pranimin e borxhit, pra vet debitori është ai që manifeston vullnetin e tij që borxhi të pranohet, andaj bazuar në të cekurat më lartë e në kuptim të nenit 368 të LMD-së, gjykata vlerësoi se pagesat e rregullta nuk e ndërprejnë parashkrimin, sepse ka dallim esencial në mes të pagesës së kistit dhe pagesave të rregullta, pagesa e kësteve mund të bëhet vetëm pas një marrëveshje në mes të kreditorit dhe debitorit për pagesën e një borxhi të caktuar në këste të caktuara, ndërsa pagesat e rregullta bëhen nga ana e debitorit varësisht nga shërbimet e marra nga kreditori, për

këtë arsye gjykata vlerësoi se pagesat e rregullta nuk paraqesin vullnet të debitorit për pranimin e borxhit paraprak në tërësi, mirëpo këto pagesa bëjnë shlyerjen e borxhit të parë të krijuar të debitorit në drejtim të kreditorit.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit dhe gjeti se pretendimet e tij janë të pa bazuara, nga se nuk hyjnë në shkaqet e parapara nga neni 71 i LPP-së, e të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbarimin e lejuar, po ashtu debitori pretendimet e tij nuk i ka mbështetur në prova, ashtu siç kërkohet me nenit 69 par.4 të LPP-së, në të cilin thuhetse “ *Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura, provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, për ndryshe prapësimi do të refuzohet*”.

Në bazë të nenit 78 par.1, 2 dhe 4 të KPP-së, gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e urdhëruar debitorin që në rast se parashtrohet ankesë kundër këtij aktvendimi, paraprakisht të paguaj garancionin në të holla si parakusht për ushtrimin e ankesës dhe gjykatës t’ia dorëzoi provën për pagesën e garancionit. Lartësia e garancionit është përcaktuar duke marr për baze shumën e borxhit për të cilën ka mbetur në fuqi urdhri përmbarues. Si dhe është paralajmëruar debitori që nëse dështon të paguaj garancionin, ankesa do të konsiderohet se nuk është parashtuar fare.

Andaj nga të cekurat më lartë, e në kuptim të nenit 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

PPP.nr.12/2022 me datën 29.01.2024

Gjyqtari,  
Lert Rexhaj

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.